

Konflikti ligjor lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore: Ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, Ligjit për AKP dhe ligjet relevante

Haxhi GASHI*

Përmbledhje Ekzekutive

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë përfaqëson njërin ndër proceset më të ndërlikuara të privatizimit në vendet post-komuniste. Privatizimi në Kosovë i ka disa specifika nga të cilat rrjedhin edhe vështirësitë e procesit dhe që mund të përmbliidhen në së paku tri arsye kryesore: 1) Privatizimi është udhëhequr nga një dualizëm institucional - organizatës ndërkombëtare - UNMIK dhe Institucioneve të Kosovës; 2) Baza ligjore konfuze dhe jo e qartë; dhe 3) Konfliktet pronësore.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të gjitha ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës me të cilat janë ndryshuar Rregulloret e UNMIK-ut janë ligje të vetme të zbatueshme. Një situatë e tillë do të duhej të ishte edhe me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), i miratuar në vitin 2008 me të cilin është ndryshuar Rregullorja e UNMIK-ut për AKM. Me gjithë këtë realitet të ri ligjor, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme ende funksionon sipas Rregullosës së UNMIK-ut 2002/13 dhe njëherësh e konsideron Rregulloren për AKM ligj në fuqi duke mos e njohur Ligjin e Kuvendit të Kosovës për AKP. Në të drejtën e brendshme në Kosovë, mohimi i AKP-së si subjekt i plotë juridik dhe si palë në procedurë është shkelje e rregullave procedurale lidhur me përfaqësimin e drejtë të palës në procedurë gjyqësore civile, por edhe shkelje e rregullave kushtetuese lidhur me një gjykim të drejtë. AKM nuk është treguar e suksesshme në përfaqësim të disa rasteve pranë gjykatave sepse me vetëdije apo pa vetëdije ka humbur shumë raste të privatizimit në mesin e të cilave vlen të përmendet rasti i Fabrikës së Çelikut në Ferizaj. Ligji për AKP, edhe pse i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me të cilin është ndryshuar Rregullorja nr. 2002/12 për AKM-në, nuk e ka arritur qëllimin e tij për shfuqizimin e Rregullosës për AKM. Andaj, nevojitet nxjerrja e një ligji të ri për Dhomën e Veçantë, ndryshimi i Ligjit për AKP, ndryshimi i Rregullosës nr. 2005/48 për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizim administrativ të AKM dhe nxjerrja e një ligji të ri për denacionalizim.

* Kjo analizë e Institutit për Studime të Avancuara GAP është shkruar nga Haxhi GASHI, Ass.Profesor i të drejtës civile/pronësore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ky opinion i shprehur në këtë punim paraqet opinion personal të autorit dhe nuk paraqet ose reflekton pozicionet e punëdhënësit të autorit ose ndonjë institucioni tjetër ku autori është i punësuar ose anëtarësuar. Autori është në përfundim të doktoraturës në Universitetin e Bremenit në Gjermani, dhe pret mbrojtjen e disertacionin e doktoraturës me titull: “Analizë krahasimore e transformimit të pronës me theks të veçantë privatizimi dhe restitucioni në vendet post-komuniste: Kosova rast *sui generis* i privatizimit”.

1. Hyrje

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë përfaqëson njërin ndër proceset më të ndërlikuara të privatizimit në vendet post-komuniste, për vetë faktin se Kosova ka specifika të dallueshme prej këtyre vendeve. Është e rëndësishme të theksohet se privatizimi në vendet post-komuniste ka rrjedhur si domosdoshmëri nga dështimi i sistemit socialist mbi argumentet shkencore se ndërmarrjet shtetërore/shoqërore nuk kanë qenë produktive, respektivisht efikente për të plotësuar kërkesat shoqërore.¹ Me rënien e murit të Berlinit që përfaqëson shembjen e komunizmit dhe konceptit ekonomik të ekonomisë socialiste,² u bë e qartë se koncepti ekonomik duhej të shkonte drejt ekonomisë së tregut të lirë, ndërsa si rrugë kryesore vlerësohej privatizimi sa më i shpejtë i pronës shtetërore/shoqërore.³ Vetë qëllimi i ekonomisë është përmbushja e kërkesave shoqërore, kurse privatizimi si pjesë e transformimit të ekonomisë socialiste në ekonomi të tregut është konsideruar e vetmja rrugëdalje nga kriza ekonomike.⁴ Në këtë kontekst, privatizimi si koncept paraqet një proces ligjor të organizuar nga shteti përmes të cilit prona shtetërore/shoqërore transformohet, respektivisht kalon në duart e pronarëve privat me qëllim që kjo pronë të jetë shumë më produktive, efikente dhe konkurruese për t'i përmbushur nevojat e shoqërisë (shërbimet e domosdoshme, prodhimit, infrastrukturën, rritjen e taksave për shtetin, cilësinë dhe sasinë e produkteve dhe shërbimeve etj).

A ka vështirësi dhe dilema procesi i privatizimit? Vendet post-komuniste kanë pasur shumë dilema dhe vështirësi rreth mënyrës se si duhet zhvilluar procesin e privatizimit. Gjatë kësaj rruge nuk ka pasur modele unike, por secili shtet ka ndjekur metoda dhe modele të ndryshme të privatizimit duke ju përshtatur rrethanave dhe specifikave ekonomike, ligjore dhe sociale të secilit shtet. Si modele të privatizimit konsiderohen: dhënia e aksioneve punëtorëve të ndërmarrjes (privatizimi i brendshëm), shpërndarja e aksioneve gjithë qytetarëve të moshës madhore (sistemi *voucher*), shitja e aksioneve investitorëve strategjik vendorë ose të huaj, si dhe kthimi i pronave ish-pronarëve, prona e të cilëve ishte nacionalizuar gjatë komunizmit pa kompensim.⁵ Në mesin e këtyre metodave më e rëndësishme dhe produktive në drejtim të zhvillimit ekonomik është treguar shitja e aksioneve investitorëve për vet faktin se në ndërmarrje është sjell kapitali dhe përvoja e re dhe ndërmarrja ka fituar titullar (pronar) të qartë që ka ndikuar edhe në vendimmarrje të qartë në biznesin e ndërmarrjes.⁶ Një model i tillë i nxjerrë nga përvoja e të tjerëve është i zbatueshëm aktualisht edhe në Kosovë. Mirëpo, të gjitha këto vështirësi i janë nënshtruar debateve të ndryshme dhe arritjes së një konsensusi shoqëror. Kosova nuk e ka pasur këtë mundësi sepse ngjarjet politike rreth

¹ Pitelis & Clarke, 1993, fq. 1; Roland & Verdier, 1994, fq. 1; Pavlinek, 2002, fq. 1127

² Shih në mes tjerëve Ramamurti, 2000, fq. 532; Havrylyshyn, 2007, fq. 2.

³ Shih në mes tjerëve Roland & Verdier, 1994, fq. 161.

⁴ Gordon, 1993-1994, fq. 517; Yilmaz, 1993, fq. 6; Kušić, 2005, fq. 13.

⁵ Bennett, Estrin, Maw & Urga, 2004, fq. 3.

⁶ Shih Kornai, 2000, fq. 6-8.

të ardhmes dhe përcaktimit të statusit politik i kanë mbuluar ngjarjet ekonomike, përfshirë edhe privatizimin. Megjithatë, duhet thënë se në të gjitha modelet e privatizimit, kushtet kryesore për sukses të privatizimit janë: *baza ligjore e qartë, drejtësia, transparenca, konkurrenca dhe konsensusi shoqëror*. Pyetja që parashtrohet është se a ka vështirësi dhe dilema privatizimi në Kosovë? Në këtë analizë fokusi do të jetë në disa specifika dhe vështirësi aktuale, posaçërisht konflikti ligjor si specifikë që paraqet sfidë serioze për privatizimin në Kosovë dhe që kërkon zgjidhje urgjente.

2. Disa specifika të procesit të privatizimit në Kosovë

Privatizimi në Kosovë i ka disa specifika nga të cilat rrjedhin edhe vështirësitë e procesit dhe që mund të përmbliidhen në së paku tri arsye kryesore:

- 1) Privatizimi është udhëhequr nga një dualizëm institucional - organizatës ndërkombëtare - UNMIK, përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe pjesëmarrjes së Institucioneve të Kosovës;
- 2) Baza ligjore konfuze dhe jo e qartë; dhe
- 3) Konfliktet pronësore në pronën që privatizohet.

Të gjitha këto janë reflektuar në vështirësitë e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Duhet shtuar se procesi i privatizimit i ka anët e veta pozitive dhe si proces është përkrahur dhe konsideruar si i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe krijimin e tregut të lirë.⁷ Mirëpo, ky proces aktualisht ka vështirësi dhe specifika që do të paraqiten në vazhdim.

2.1 Udhëheqja e Procesit të Privatizimit. Privatizimi është udhëhequr nga AKM, por me një përfaqësim edhe të institucioneve vendore. Megjithatë fjala e fundit vendimmarrëse ishte e UNMIK-ut, sepse vota vendimtare ishte e zëvendësit të PSSP-së si kryesues i Bordit të AKM-së.⁸ Kjo përbën një specifikë, sepse një institucion ndërkombëtar ka udhëhequr dhe përcaktuar politikat e procesit të privatizimit. Kjo është një prej aspekteve pozitive sepse është shfrytëzuar eksperiencia e ekspertëve ndërkombëtar. Vendet post-komuniste nuk e kanë pasur këtë eksperiencë, përfshirë edhe Kosovën. Megjithëse ka pasur pajtim dhe konsultime me institucionet vendore, në shumë raste janë shfaqur edhe mospajtime në mes të institucioneve vendore dhe atyre të UNMIK-ut rreth privatizimit, sidomos modelit të privatizimit, procesit dhe vendimmarrjes në privatizim. Dualizmi i institucioneve në

⁷ Procesi i privatizimit në Kosovë ka qenë proces i domosdoshëm për të penguar shkatërrimin e mëtejshëm të kapitalit të ndërmarrjeve shoqërore, sjelljen e kapitalit dhe përvojës së re, rritjen e efikasitetit të ndërmarrjeve shoqërore dhe hapjen e ekonomisë drejtë ekonomisë së tregut të lirë. Një proces i tillë është përkrahur gjerësisht.

⁸ Më shumë për përbërjen e Bordit të AKM-së shih, Rregullorja nr. 2002/12 për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, neni 11 dhe 12. Kjo Rregullore paraqet bazën ligjore të administrimit dhe privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, organizimin e AKM-së dhe modelin e privatizimit.

vendimmarrje në privatizim ka ndikuar në marrjen e vendimeve jo rrallë të gabuara, me të vetmin aspekt? harmonizimin e qëndrimeve. Një situatë e tillë e debatueshme për ekonominë e Kosovës është vetë Fondi i Privatizimit i cili nuk është pjesë e zhvillimit ekonomik të Kosovës.⁹ Mirëpo, për shkak të kontesteve pronësore, ky model e krijon mundësinë që të sigurohen mjete si garanci për kompensim të pronarëve ose kreditorëve legjitim ashtu siç kërkohet sipas KEMDNJ, Protokollit 1, nenit 1, ndërsa procesi i privatizimit të vazhdoj si proces i domosdoshëm për zhvillim ekonomik.¹⁰

2.2. Baza Ligjore Konfuze. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, ligje të zbatueshme në Kosovë janë përcaktuar: Ligjet në fuqi deri me 22 mars 1989, respektivisht para suprimimit të autonomisë së Kosovës, Rregulloret e UNMIK-ut, Ligjet e Kuvendit të Kosovës. Ndërsa ligjet e nxjerra pas vitit 1989 janë konsideruar të zbatueshme vetëm nëse ka zbrazëtirë ligjore dhe nuk janë të karakterit diskriminues.¹¹ Një prej defekteve kryesore është mungesa e saktësisht se cilat ligje pas 22 marsit 1989 duhet të përjashtohen nga zbatimi dhe cilat mund të zbatohen por që nuk kanë karakter diskriminues.¹² Mungesa e një sqarimi të tillë fatkeqësisht krijoi mundësinë

⁹ Një prej vendimeve të debatueshme për ekonominë e Kosovës është Fondi i Privatizimit. Mjetet e këtij fondi nuk janë mjete në qarkullim në ekonominë e Kosovës, por Fond i izoluar, që në radhë të parë është formuar dhe ka qëllim të shërbejë për zgjidhjen e kontesteve pronësore në ndërmarrjet e privatizuar. Për dallim prej vendeve tjera në tranzicion si p.sh Sllovenia, Kroacia, Hungaria, Çekia, Poloni, Gjermania Lindore, që kishin formuar Fonde të Zhvillimit, në mesin e të cilave Fondi i Privatizimit ishte përdorur si Fond Zhvillimi, në Kosovë ky Fond *prima facie* shërben për zgjidhjen e kontesteve pronësore dhe si i tillë ende mbetet Fond i izoluar dhe nuk është përdorur për zhvillim ekonomik.

¹⁰ Sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEMDNJ), Protokolli, 1, neni 1, kërkohet sigurimi i mjeteve të nevojshme për kompensimin e pronarëve ose kreditorëve nëse me veprime të shtetit merret prona për qëllim publik. Si qëllim publik dhe formë e shpronësimit kur ka konteste pronësore konsiderohet edhe privatizimi. Prandaj, një qëndrim i tillë në Kosovë lidhur me Fondin e Privatizimit është në pajtim me kërkesat që dalin nga KEMDNJ. Një Fond i tillë nuk mund të shpenzohet derisa të zgjidhen kontestet pronësore.

¹¹ Shih, Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 1999/24, për ligjin e zbatueshëm në Kosovë, e amenduar me Rregulloren, nr. 2000/59, neni 1.1 dhe 1.2: “1.1. Ligji në fuqi në Kosovë përfshin: a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe b) Legjin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. 1.2 Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjisllacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjisllacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

¹² Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/10 për shfuqizimin e legjisllacionit për çështje banesore dhe të drejtat mbi pronën, vetëm dy ligje janë përjashtuar nga zbatimi në Kosovë - Ligji për Ndryshime dhe Shtesa në Kufizimin e Transaksioneve të Pasurisë së Patundshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, 22/91 e datës 18 prill 1991); dhe Ligji për Kushtet, Mënyrat dhe Procedurat e Dhënies së Tokës Bujqësore Qytetarëve që Dëshirojnë të Punojnë dhe Jetojnë në Territorin e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, 43/91 e datës 20 korrik 1991).

që shumë ligje të nxjerra pas viti 1989 të zbatohen në praktikë. Me vendosjen e Kosovës nën administrimin e UNMIK, bazuar në Rregulloren nr. 1999/1 mbi administrimin e përkohshëm të Kosovës, UNMIK- ishte përgjegjës për administrimin e pronës publike dhe shtetërore në Kosovë.¹³ Pavarësisht këtij fakti, shumë prona shoqërore dhe publike janë transformuar, respektivisht privatizuar, bazuar në ligjet e lëshuara nga Serbia gjatë viteve të 90-ta si rezultat i mos përjashtimit nga zbatimi i ligjeve të lidhura me transformimin (privatizimin) e pronës.¹⁴

2.3 Kontestet Pronësore. Procesin e privatizimit në Kosovë e përcjellë edhe fenomeni i kontesteve pronësore në ndërmarrjet e privatizuara ose ato në privatizim. Ndërmarrjet shoqërore i janë nënshtruar një procesi të transformimit të dhunshëm nga Serbia gjatë viteve të 90-ta. Në këtë drejtim shumë kërkesa pronësore lidhur me këtë transformim janë paraqitur pranë Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme. Përveç kësaj kategorie, kërkesa pronësore janë edhe të ish-pronarëve, prona e së cilëve ishte marrë në mënyra të ndryshme (nacionalizuar, shpronësuar ose konfiskuar) gjatë kohës së komunizmit. Kategoria e tretë e kërkesave potenciale janë ato të investitorëve të supozuar që kanë investuar ose kredituar ndërmarrjet shoqërore gjatë viteve të 90-ta. Edhe pse me Rregulloren e UNMIK-ut për AKM-në dhe me Ligjin për AKP-në, kërkesat pronësore nuk mund të ndalin procesin e privatizimit, dhe nuk do të ketë kthim të pronave, por mjetet e shitjes do të ruhen në fond të mirëbesimit,¹⁵ megjithatë këto kërkesa mund të jenë objekt i shqyrtimit gjatë procesit të likuidimit nga AKP dhe së fundi edhe nga vetë gjykata-Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme. Prandaj, bazat e paqarta ligjore do të paraqesin sfidë serioze në zgjidhjen e këtyre kontesteve.

3. Konfuzioni ligjor dhe problemi i zbatimit të ligjit në procesin e privatizimit: Konflikti i AKP-së me Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme

Me 17 shkurt 2008 është shpallur Pavarësia e Kosovës e cila ka krijuar një situatë të re politike dhe juridike. Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së

¹³ Shih Rregullorja nr. 1999/1 për autorizimet e administratës së përkohshëm në Kosovë, neni 6 i cili thotë: “UNMIK-u administron pasurinë e tundshme ose të patundshme, duke përfshirë financat, llogaritë bankare dhe format e tjera të pronës të regjistruara në emër të Republikës Federative të Jugosllavisë, të Republikës së Serbisë apo të cilitdo organ të saj, të cilat gjendet në territorin e Kosovës”.

¹⁴ Në praktiken para dhe pas viti 1999, ekzistojnë shumë vendime të gjykatave vendore lidhur me kthimin e pronave dhe privatizimin e banesave në pronësi shoqërore bazuar në Ligjet e Serbisë të nxjerra pas vitit 1990; Ligjit për privatizimin i viti 1991 dhe Ligjit për privatizimin e banesave në pronësi shoqërore i viti 1992. Kthimi i pronave ish-pronarëve është bërë edhe sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i viti 1978, duke e shfrytëzuar mundësin e anulimit të kontratave për marrjen e pronës me dhunë gjatë periudhës së komunizmit.

¹⁵ Shih Rregullorja nr. 2002/12, e ndryshuar me Rregulloren nr. 2005/18 neni 5 dhe 6; Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 2.

Republikës së Kosovës me 15 qershor 2008, të gjitha ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës me të cilat janë ndryshuar Rregulloret e UNMIK-ut janë ligje të vetme të zbatueshme. Një situatë e tillë do të duhej të ishte edhe me Ligjin Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), i miratuar në vitin 2008 me të cilin është ndryshuar Rregullorja e UNMIK-ut për AKM nr.2002/12. Si rezultat i këtij ligji, AKP është themeluar si pasardhës i AKM-se, ndërsa të gjitha përgjegjësitë e AKM-së kanë kaluar në AKP.¹⁶ Kjo ka një rëndësi të veçantë sepse i tërë procesi i privatizimit përfshirë edhe përfaqësimin e rasteve pranë Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme duhej të udhëhiqej nga institucionet e Kosovës, respektivisht AKP dhe jo AKM.

Me gjithë këtë realitet të ri ligjor, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme ende e konsideron Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 për AKM ligj në fuqi dhe nuk e njeh Ligjin e Kuvendit të Kosovës për AKP. Sipas Dhomës së Veçantë, vetëm AKM është kompetente për t'i përfaqësuar rastet pranë gjykatës, pavarësisht faktit se pasojat juridike dhe ekonomike janë për Kosovën. Një qëndrim të tillë Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme e bazon në një Opinion Ligjor të lëshuar nga zyra e UNMIK-ut në vitin 2009 me të cilin sqarohet se cili Ligj konsiderohet në fuqi rreth çështjeve të privatizimit. Në mes tjerash UNMIK-u ka shpjeguar se vetëm Rregullorja e AKM-së 2002/12 është ligj në fuqi dhe jo ligji për AKP, me arsyetim se Ligji i Kuvendit të Kosovës nuk mund t'i shfuqizojë Rregulloret e UNMIK-ut.¹⁷ Si pasojë e këtij opinioni, Dhoma e Veçantë e njeh vetëm AKM-në kompetente për vendim përfundimtar dhe përfaqësimin e rasteve pranë gjykatës. Kjo gjykatë nuk e njeh Ligjin për AKP si ligj të zbatueshëm por vetëm si rregullore të brendshme të Agjencisë së Privatizimit por pa fuqi ligjore.¹⁸ Një qëndrim i tillë i Dhomës së Veçantë është shkelje e ligjit në Kosovë, Kushtetutës së Kosovës, dhe Planit Gjithëpërfshirës të Ahtisarit.¹⁹ Për më shumë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se Dhoma e

¹⁶ Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 1 dhe 31. Në nenin 1 thuhet: "Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej "Agjencia") themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Agjencia ka zotësi të plotë juridike...Agjencia themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 "Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit", me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë". Ky ligj e shfuqizon Rreg 2002/12. Në nenin 31 thuhet: "Ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të. Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, me ndryshimet dhe plotësimet e saj, nuk do të prodhojë efekte juridike pas hyrjes në fuqi të këtij ligji".

¹⁷ UNMIK/RREG/2008/4- Clarification, 12 November 2009.

¹⁸ Shih Vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-09-0089, faqe III, ku thuhet shprehimisht: "Kjo nuk nënkupton se Dhoma e Posaçme e pranon Ligjin për AKP si ligj të zbatueshëm në Kosovë, por për të siguruar një proces privatizimi të drejtë dhe të sigurt, ky ligj duhet të konsiderohet si rregulla të brendshme të organizatës të vlefshme dhe detyruese brenda procesit të privatizimit". Po ashtu shih Vendimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, ASC-09-0067, datë 9 Mars 2010, faqe, IV. Me këtë vendim gjykata e shpreh të njëjtin qëndrim duke e injoruar zbatimin e Ligjit për AKP.

¹⁹ Shih, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ref. AGJ 109/2011, në rastin KI 25/10, Agjencia Kosovare e Privatizimit kundër Vendimit të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-089, të katër shkurtit 2010, paragrafët, 53-57.

Veçantë me veprimet e saja nuk e njeh Ligjin e nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës që paraqet shkelje të Kushtetutës dhe vazhdon ta injorojë ekzistimin e Kosovës si shtet.²⁰ Ndërkohë, Opinioni i GJND-së ka konfirmuar se shpallja e Kosovës si shtet ka qenë në harmoni të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të OKB-së.²¹ Në të drejtën e brendshme në Kosovë, mohimi i AKP-së si subjekt i plotë juridik dhe si palë në procedurë është shkelje e rregullave procedurale lidhur me përfaqësimin e drejtë të palës në procedurë gjyqësore civile,²² por edhe shkelje e rregullave kushtetuese lidhur me një gjykim të drejtë.²³ Për më tepër, një veprim i tillë i Dhomës së Veçantë paraqet edhe shkelje të nenit 6 të KEMDNJ-së (Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore), që garanton gjykimin e drejtë dhe të paanshëm në proces gjyqësor.²⁴ Të gjitha argumentet e lartpërmendura tregojnë se veprimet e Dhomës së Veçantë nuk respektojnë sistemin juridik në Kosovë dhe hierarkinë e ligjeve, gjë që krijon pasoja të pariparueshme për Kosovën.

4. Ndryshimi i Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2002/13 për Dhomën e Veçantë si çështje urgjente

Ndryshimi i Rregullores nr. 2002/13 për Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme duhet të konsiderohet si çështje urgjente për të evituar konfliktin ligjor për privatizimin e NSH në Kosovë. Me ndryshimin e kësaj rregullore do të definoheshin qartë kompetencat e kësaj gjykate duke e detyruar atë të njeh ligjet e Kuvendit të Kosovës si ligje të zbatueshme. Në veçanti duhet të adresohet çështja e Ligjit për AKP dhe përfaqësimi i rasteve pranë kësaj gjykate. Këto fakte kanë qenë të njohura për institucionet e Kosovës, të cilat kanë qenë të këshilluara që nga viti 2008 që ta ndryshojnë këtë rregullore dhe të nxjerrin një ligj të ri për Dhomën e Veçantë, mirëpo një gjë e tillë asnjëherë nuk u realizua. Një problem i tillë është potencuar

²⁰ Shih Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i cituar, par. 53 në të cilin thuhet: “*Ne këto rrethana, Gjykata vetëm mund të vijë në përfundim se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk njeh dhe zbaton ligjet e miratuara ligjërisht nga Kuvendi. Në fakt, Dhoma e Posaçme thjeshtë vazhdon ta injoroi ekzistimin e Kosovës si shtet të pavarur dhe ligjet që burojnë nga Kuvendi i saj.*”

²¹ Po aty.

²² Ligji i procedurës kontestimore, nr. 03/L-006, neni 5, par. 1 i cili thotë: “Gjykata do t’i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare”, dhe neni 7, par. 3 që thotë: “Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen” në lidhje me nenin 182, par 2, pika (i) e cila thotë: “182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë...(i) në qoftë se ndonjëherë nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë”.

²³ Shih Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31.

²⁴ Më gjerësisht shih Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, neni 6

vazhdimisht edhe nga AKP në raportim pranë Kuvendit të Kosovës.²⁵ Me këto raporte AKP ka theksuar vështirësitë në raport me Dhomën e Veçantë lidhur me përfaqësimin e rasteve të privatizimit. Institucionet si duket e kanë keqkuptuar situatën duke menduar se me Ligjin e Gjykatave të vitit 2010 është zgjidhur problemi i gjykatave dhe i Dhomës së Veçantë, që shpesh është dhënë arsytim “se nuk kemi nevojë për një ligj për Dhomën e Veçantë që është organ i UNMIK-ut”. Kompetenca e Dhomës së Veçantë mund të ndryshohet vetëm me ligj të veçantë për këtë gjykatë, respektivisht duke e ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13. Duke injoruar veprimin e kësaj gjykate, pasojat mund të jenë të mëdha, që vlen të theksohet rasti për Trepçën por dhe për vetë Fondin e Privatizimit që duhet të adresohet sipas vendimeve të kësaj gjykate. I tërë Fondi i Privatizimit duhet të adresohet nga kjo gjykatë bazuar në kërkesat e kreditorëve dhe pronarëve potencialë ose të simuluar. Në anën tjetër, përfaqësimi i rasteve pranë Dhomës së Veçantë nga ana e AKM-së është anakronike kur dihet fakti se tani me Ligjin e AKP-së vetëm AKP është kompetente. Për më shumë, AKM nuk është treguar e suksesshme në përfaqësim të disa rasteve pranë gjykatave sepse me vetëdije apo pa vetëdije ka humbur shumë raste të privatizimit në mesin e të cilave vlen të përmendet rasti i Fabrikës së Çelikut në Ferizaj, në të cilin Gjykata Komunale në Ferizaj e detyron Qeverinë e Kosovës, respektivisht AKP-në me **25.649.250 euro** me kamatë vjetore prej 3% në vit nga viti 2002, që arrin një shumë afërsisht **30 milion euro**, kompensim për pagat e punëtorëve të larguar nga puna si rrjedhojë e masave të dhunshme të Serbisë në ndërmarrjet shoqërore gjatë viteve të 90-ta. Një vendim i tillë ka ardhur si pasojë e mos shfrytëzimit të ankesës kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr. 340/2001. Në këtë mënyrë, vendimi edhe pse i kundër ligjshëm merr formën e prerë. Si rrjedhojë e kësaj, *bazuar në parimin e drejtësisë se vendimi i formës së prerë duhet zbatuar*, Gjykata Kushtetuese me një vendim duke e konsideruar vendimin C.nr. 340/2001 si *res judicata* (çështje të gjykuar) urdhëron zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj C.nr. 340/2001.²⁶ Por, sa është i ligjshëm vendimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr. 340/2001? Kosova nuk mund të jetë përgjegjëse për veprimet e dhunshme në NSH të ndërmarrja nga Serbia gjatë viteve të 90-ta, përfshirë edhe largimin nga puna të punëtorëve. Ekzistojnë edhe raste ndërkombëtare ku shtetet nuk marrin përgjegjësinë për veprimet e një shteti tjetër. Rast i ngjashëm është ai i Gjermanisë e cila nuk ka pranuar përgjegjësinë për kërkesat pronësore lidhur me shpronësimet nga viti 1945 deri më 1949 si pasojë e Okupimit Sovjetik me arsytimin se Gjermania nuk mund të jetë përgjegjëse për veprimet e një shteti tjetër.²⁷ Madje, as ndërmarrjet shoqërore që janë në privatizim nuk janë përgjegjëse për kompensim të çfarëdo page apo dëmi

²⁵ Shih Raporti Vjetor 2008-2009 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, fq. 5. Në këtë raport AKP në mënyrë eksplicite i ka shprehur shqetësimet e veta lidhur me vendimet e Dhomës së Veçantë dhe faktin se kjo gjykatë nuk e njeh AKP-në si subjekt juridik publik dhe as vetë Ligjin për AKP.

²⁶ Shih Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Ref.nr.:AGJ 75/2010, datë 17 Dhjetor 2010.

²⁷ Shih Allen, 2006-2007, fq. 3; Blacksell & Born, 2002, p.179; Karadjova, 2004, fq. 332; Preuß, 1993, fq. 50

tjetër gjatë viteve të 90-ta. NSH që janë në privatizim konsiderohen ndërmarrjet sipas statusit juridik që kanë pasur para 22 marsit 1989, respektivisht para suprimimit të autonomisë së Kosovës me dhunë nga Serbia.²⁸ Ndonjë ndryshim në statusin juridik të tyre pas vitit 1989 merret parasysh vetëm nëse është në pajtim me ligjin në fuqi që nënkupton Ligjet e Markoviçit para vitit 1989,²⁹ dhe nuk janë të karakterit diskriminues.³⁰ Ndërsa, çfarëdo ndryshimi i statusit të ndërmarrjeve shoqërore pas vitit 1999, respektivisht pas vendosjes së administrimit ndërkombëtar është i kundërligjshëm nga cilido organ, përfshirë edhe gjykatat sepse UNMIK-u, e më vonë AKM, ishin përgjegjëse për administrimin e pronës shoqërore dhe publike.³¹ Fakte shtesë për mos-besueshmërinë e AKM-së në përfaqësim të rasteve pranë gjykatave është edhe asgjësimi i shumë dokumenteve në kohën e dorëzimit të funksionit të AKM te AKP që vë dyshime lidhur me transparencën e funksionimit të AKM-së.³² Edhe në një raport të OSBE-së është kritikuar puna e Dhomës së Veçantë sepse vepron në një ambient të paqartë ligjor dhe me procedura jo transparente dhe është vënë në pikëpyetje paanshmëria e gjyqtarëve.³³ Prandaj, qëndrimi i Dhomës së Veçantë se vetëm AKM mund të përfaqësojë rastet pranë gjykatës dhe injorimi i ekzistimit të Ligjit për AKP dhe vetë AKP-në si subjekt juridik dhe përfaqësues legjitim, është në çdo aspekt i kundërligjshëm për rrethanat politike dhe juridike në Kosovë.

Se sa të rëndësishme janë rastet pranë Dhomës së Veçantë dhe vetë roli i kësaj gjykate në vendimmarrje tregon edhe vendimi i fundit i Dhomës së Veçantë me të cilin kërkohet vendosja e një Administratori Ndërkombëtar mbi Trepçën.³⁴ Kjo situatë tani e krijuar si pasojë e neglizhencës në nxjerrjen e një Ligji për Dhomën e Veçantë, por edhe një Ligji për Trepçën, e sjell Trepçën në një situatë tjetër nga Moratoriumi për Trepçën. Administratori do të ketë kompetenca: 1) për riorganizimin e Trepçës dhe krijimin e një ndërmarrje të re, kështu që të mund të krijohej edhe mundësia e shlyerjes së borxheve të mundshme. Ky do të ishte varianti më i mirë sepse juridikisht do të shuhej ndërmarrja e vjetër por në vend të saj do të krijohej ndërmarrja e re Trepça por pa borxhe; 2) privatizimi i Trepçës me metodën e privatizimit të ndërmarrjeve publike; dhe 3) varianti më i keq - likuidimi i Trepçës dhe shitja e aseteve të saja - me çmime tejet të lira dhe shlyerja e borxheve. Këto kompetenca tani nuk janë në Institucionet e Kosovës (AKP), por janë në duart e administratorit bazuar në një vendim të

²⁸ Shih Rregullorja nr. 2002/12 për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, neni 5.

²⁹ Ligji ndërmarrjet i viti 1988, Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 77/1988; Ligji për kapitalin shoqëror i viti 1989 (i njohur si ligji për transformimin e ndërmarrjeve shoqërore), Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 84/1989.

³⁰ Vendimi i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, SCC-04-0188, date 58/11/2006, fq.10.

³¹ Vendimi i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, SCC-4-0087, date 15/09/2006.

³² Raporti 2008-2009 i Agjencinë Kosovare të Privatizimit, fq. 8, 15, dhe 16. Në këtë raport janë paraqitur dëshmi të djegies dhe asgjësimit të dokumenteve të privatizimit nga AKM.

³³ Raporti i OSBE-së, Privatizimi në Kosovë: Shqyrtimi Juridik i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, Maj 2008, fq. 42.

³⁴ Shih Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, Vendimi nr. SCR-05-001, 26 Janar 2011.

Dhomës së Veçantë që e krijon një situatë të re juridike të pafavorshme për Kosovën.

Nga ajo që u tha më lartë, ndryshimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme është çështje urgjente, në mënyrë që kjo gjykatë të veprojë sipas Ligjit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të respektojë sistemin juridik në Kosovë.

5. Ndryshimi i Ligjit për AKP

Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), edhe pse i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me të cilin është ndryshuar Rregullorja nr. 2002/12 për AKM-në, nuk e ka arritur qëllimin e tij. Në Ligjin për AKP duhet të shtohet shprehimisht se përfaqësimi i rasteve të privatizimit nga AKM është i ndaluar, kurse vetëm AKP është kompetente. Ligji për AKP nuk jep ndonjë zgjidhje për kërkesat pronësore të ish-pronarëve, përveç që thuhet se kërkesat pronësore nuk e ndalin procesin e privatizimit, ndërsa këto kërkesa mund të kompensohen nga fondi i privatizimit. Prandaj, në këtë ligj duhet të saktësohet se shfuqizohet çdo ligj i nxjerrë nga Serbia pas viti 1989 që ka të bëjë me kthimin e pronave ose forma tjera të privatizimit, deri në nxjerrjen e një ligji përkatës për trajtimin e kërkesave pronësore të ish-pronarëve. Në Ligjin për AKP, duhet të sqarohet çështja e Fondit të Privatizimit dhe të krijohet mundësia që këto mjete të investohen në ekonominë e Kosovës në mënyrë që të gjenerohen vende të reja të punës.

6. Ndryshimi i Rregullores 2005/48 për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit

Kjo rregullore e cila paraqet bazën kryesore ligjore mbi të cilën do të zgjidhen kërkesat pronësore dhe të kreditorëve gjatë procedurës së likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të ndryshohet dhe të shndërrohet në Ligj të Republikës së Kosovës. Kjo rregullore ka mjaft referenca të cilat e ngarkojnë vetëm AKM-në si përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve rreth privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Prandaj, nuk duhet lejuar baza të tilla ligjore ku gjykatat mund të thirren për marrjen e vendimeve të rëndësishme në kontestet pronësore. Rregullorja nr.2005/48 nuk lejon mundësinë që disa ndërmarrje të riorganizohen dhe të transformohen në ndërmarrje publike. Kjo do të ishte me interes për disa ndërmarrje vitale për ekonominë e Kosovës që të marrin statusin e ndërmarrjeve publike. Ndërsa, privatizimi i tyre për qëllim të zhvillimit ekonomik mund të jetë sipas metodës së privatizimit të

ndërmarrjeve publike, respektivisht dhënien me koncesion ose partneritet-publiko privat.

7. Nxjerrja e Ligjit për denacionalizim (restitucion ose kompensim) të pronave të nacionalizuara nga komunizmi

Nxjerrja e Ligjit për Denacionalizimin është një prej ligjeve që duhet konsideruar pako e ligjeve për privatizim. Edhe pse ndoshta nuk është momenti që Kosova t'i hyjë zgjidhjes së këtij problemi mjaft të ndërlikuar, kjo është e domosdoshme për arsye se një numër i konsiderueshm i kërkesave pronësore pranë gjykatës janë të lidhura me kthimin e pronave të nacionalizuara ose shpronësuar gjatë periudhës së komunizmit.³⁵ Në procedurën e likuidimit, gjithsesi se duhet të trajtohen edhe këto kërkesa pronësore. Prandaj, mungesa e një baze të qartë ligjore mund të lejojë zbatimin e ligjit në mënyra të ndryshme për raste të njëjta. Për më shumë, fakti se nuk janë shfuqizuar ligjet e Serbisë të nxjerra pas viti 1990 lidhur me kthimin e pronave, ekziston rreziku i zbatimit të ligjeve të tilla nga ana e gjykatave, ku një gjë e tillë edhe ka ndodhur në praktikë. Kështu, ligji për denacionalizimin është i domosdoshëm për një transparencë në procedurën e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe zgjidhjes së kontesteve pronësore të kësaj natyre në mënyrë të njëjtë për të gjithë qytetarët.

Nuk ekziston ndonjë akt ndërkombëtar që i detyron shtetet për kthimin e pronave të nacionalizuara gjatë periudhës së komunizmit. Madje, as praktika e Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut nuk ka mundur t'i detyrojë shtetet për kthim të pronave për shkak se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut me protokollin 1, neni 1, nuk ka veprim retroaktiv në kohën kur kanë ndodhur nacionalizimet e pronave sepse këto vende nuk kanë qenë nënshkruese të Konventës.³⁶ Edhe pse zgjidhja e kontesteve pronësore lidhur me pronat e ish-pronarëve ka qenë një ndër sfidat e privatizimit dhe frikë për ndaljen e procesit të privatizimit,³⁷ të gjitha shtetet post-komuniste janë marrë me zgjidhjen e këtij problemi si domosdoshmëri e sqarimit të të drejtave pronësore si parakusht për një treg të lirë por edhe për krijimin e një drejtësie shoqërore. Në Kosovë situata është ndryshe nga vendet tjera sa i përket këtij problemi. Është thënë më lartë se ligjet e Serbisë për kthimin e pronave (denacionalizimin) nuk janë shfuqizuar. Si rezultat i këtij defekti ligjor, në Kosovë ka mjaft raste ku një kategori e qytetarëve (pjesa më e madhe e nacionalitetit Serb por pa i përjashtuar edhe të tjerët) duke i shfrytëzuar

³⁵ Shih në mes tjerash Aktgjykimi i Dhomës së Veçantë, nr. SCC-04-0112, date 11/10/2007. Në këtë rast pala ka kërkuar kthimin e pronës së shpronësuar (ekspropriuar) në vitin 1959.

³⁶ Shih në mes rasteve tjera, *Gratzinger v. Czech Republic*, App. No. 39794/98, *Szechenyi v. Hungary*, App. No. 21344/93; *Geblusek v. Hungary*, App. 23318/94; *Polacek v. Czech Republic*, App. No. 38645/97; *Pezoldová v. Czech Republic*, App. No. 28390/95.

³⁷ Shih, *Brus*, 1993, fq. 47-48; *Gelpert*, 1993-1994, fq. 322.

këto ligje i kanë kthyer pronat e marra gjatë periudhës së komunizmit, madje tani ato prona edhe shiten në treg. Në këtë kategori hyn kthimi i pronave bujqësore dhe banesave. Prandaj, ekziston kategoria tjetër e qytetarëve të cilët nuk i kanë shfrytëzuar këto ligje si bazë për kthimin e pronave të tyre. Nëse brenda një shteti ekzistojnë baza ligjore mbi të cilën disa qytetarë realizojnë të drejtën e kthimit të pronave, ndërsa pjesa tjetër e qytetarëve nuk e gëzon këtë të drejtë, kjo paraqet shkelje të nenit 14, nenit 1 të Protokollit 1, dhe Protokollit 12 të KEMDNJ që sigurojnë mbrojtjen e pronës dhe trajtim të barabartë të gjithë qytetarëve para ligjit.³⁸ Në anën tjetër, në mungesë të bazës së qartë ligjore mund të supozohet se gjykatat e rregullta vendore, përfshirë edhe Dhomën e Veçantë do të vazhdojnë t'i shfrytëzojnë ende këto ligje si bazë për zgjidhjen e kontesteve të kësaj natyre. Përveç faktit se trajtimi i restitucionit është kërkesë për respektimin e të drejtës së barabartë të qytetarëve para ligjit, çështja e trajtimit të restitucionit është detyrim që buron edhe nga Plani Gjithëpërfshirës i Ahtisarit.³⁹

Kosova nuk duhet të lejojë që çështja e kthimit të pronave të zgjidhet në mënyrë stihike ashtu që duke shfrytëzuar hapësirat ligjore të shfrytëzohen ligje të cilat bien në konflikt me ligjet e privatizimit, respektivisht Rregulloren për AKM dhe Ligjin për AKP. Kjo situatë ligjore lejon një **formë spontane për kthimin e pronave** të cilin shtetet tjera post-komuniste e kanë evituar duke krijuar sistem të centralizuar përmes një Plani Strategjik për kthim të pronave, respektivisht kompensimin dhe kanë nxjerrë Ligjet përkatëse.⁴⁰ Pse e themi këtë? Kosova ka nevojë të hartojë një Plan për mënyrën e trajtimit të kthimit të pronave në mënyrë të njëjtë për të gjithë qytetarët. Kosova duhet të marrë qëndrim politik dhe juridik se si do të kthehen këto prona, në çfarë shume mund të kompensohen, cilat baza ligjore të sistemit ish-komunist mund të thirren ish-pronarët për kthim të pronës, etj.

³⁸ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, neni 14 thotë: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”. Ndërsa Protokollit 12, neni 1, thotë: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura me ligj duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike ose çdo opinion tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”.

³⁹ Shih Plani Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 Mars 2007, Aneksi VII, neni 6.

⁴⁰ Shih për shembull: Ligji për denacionalizim i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare, nr. 20/98 dhe nr. 43/2000; Ligji i Kroacisë për kompensimin e pronave të marra gjatë Jugosllavisë komuniste, Gazeta Zyrtare, nr. 92/1996; Ligji i Sllovenisë për Denacionalizimin, Gazeta Zyrtare, nr. 27/1991; Ligji i Gjermanisë për zgjidhjen e kërkesave pronësore, i miratuar me 18 Prill 1991; ligjet e Çekisë, i ashtuquajtur Ligji për restitucionin e vogël (Law on Mitigation of the Consequences of Certain Property Losses, No. 403/1990, dated 2 October 1990 amended by Law No. 458/1990 dated 30 October 1990 and entered into force on 1 November 1990) dhe Ligji për rehabilitimin jashtë gjyqësor (Law on Extrajudicial Rehabilitation), Nr. 87/1991, 22 Shkurt 1991, i ashtuquajtur Ligji për Restitucionin e Gjerë, etj.

Një argument i frikës për trajtimin e çështjes së kthimit të pronave pa bazë të qartë ligjore janë vetë rastet e paraqitura pranë AKP dhe Dhomës së Veçantë. Pyetja parashtrohet se çfarë qëndrimi do të marrë gjykata nëse një pronar dëshmon se ka dokument pronësie (tapi) mbi një ndërmarrje shoqërore ose pjesë të saj por që është nacionalizuar gjatë periudhës së komunizmit. Si to të zgjidhet ky rast? Të gjitha vendet post komuniste nuk kanë lejuar kthimin e pronave ish-pronarëve nëse prona ka qenë në shfrytëzim për interes publik ose është shitur te personi i tretë me mirëbesim (transaksionet *bona fide*), por kanë krijuar mundësinë e dhënies së kompensimit me pronë tjetër ose kompensim në para.⁴¹ Kjo është e lejuar edhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Protokolli 1, neni 1, sepse kur janë në pyetje interesat publike shtetet gëzojnë të drejtën e ndërhyrjes në pronën private.⁴² Vlerësimi i nevojave publike në rrethanat e reformave ekonomike është mjaft i gjerë nën të ashtuquajturën margjinë e vlerësimit (*margin of appreciation*).⁴³ Madje, edhe modeli i kompensimit dallon në shtetet post-komuniste dhe nuk ka qëndrim unik. Secili shtet ka përcaktuar shkallën e kompensimit duke pasur parasysh nevojat dhe interesin publik. Si shembull, Hungaria nuk ka lejuar kthimin e të njëjtës pronë, por vetëm kompensim dhe atë vetëm kompensim në një shumë të kufizuar.⁴⁴ Pyetja mund të parashtrohet si do të vepronte gjykata me pretenduesit në pronën si p.sh të Trepçës ose të ndërmarrjeve tjera shoqërore nëse eventualisht dalin pronarë që kanë Tapi-dokument pronësor mbi Trepçën ose ndërmarrjet tjera. Nëse me Ligjin për AKP është përcaktuar se nuk ka kthim të pronës por vetëm kompensim, sërish pyetja parashtrohet se sa do të jetë kompensimi, a përfshinë vlerën e plotë të tregut apo ndonjë vlerë të kufizuar duke pasur parasysh mundësitë buxhetore të Kosovës? Prandaj, Kosova ka nevojë për një infrastrukturë ligjore mbi bazën e të cilës mund të zgjidhen kontestet e tilla. Me këtë do të pengohet nxjerrja e vendimeve të cilat nuk kanë për bazë qëllimin publik dhe interesin e vendit.

⁴¹ Shih *Tucker-Mohl*, 2005, fq. 18-17; *Sinn*, 1992, fq. 2, Ligji për denacionalizim i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare, nr. 20/98 dhe nr. 43/2000, nenet 10-11; Ligji i Kroacisë për kompensimin e pronave të marra gjatë Jugosllavisë komuniste, Gazeta Zyrtare, nr. 92/1996, nenet, 1 par. 3 dhe 4 dhe nenet 52-56; Ligji i Sllovenisë për Denacionalizimin, Gazeta Zyrtare, nr. 27/1991, nenet 19 dhe 20.

⁴² Shih KEMDNJ, Protokolli 1, neni 1, i cili thotë: “Çdo person fizik ose moral ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve që të vënë në fuqi ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave”.

⁴³ Shih Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, *James v. United Kingdom*, App. No. 8793/79, Aktgjykimi i datës 21 shkurt 1986, par. 46.

⁴⁴ *Neff*, 1992, fq. 374, *Hanley & Treiman*, 2004, fq. 241, *Heller & Serkin*, 1999, fq. 1387, *Gelpert*, 1994, fq. 319.

Përfundim

1. Në procesin e privatizimit në Kosovë ekziston një konflikt ligjor si pasojë e të cilit për marrjen e vendimeve gjyqësore mund të shërbejnë baza të ndryshme ligjore. Në këtë drejtim, nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme nuk respektohet sistemi juridik në Kosovë.
2. Kundërshtimi i përfaqësimit të rasteve nga AKP në Dhomën e Veçantë, mohon të drejtën e institucioneve të Kosovës-AKP-së për mbrojtjen e interesave ekonomike-pronësore në rastet gjyqësore të lidhura me privatizimin.
3. Për disa ndërmarrje me interes vital në Kosovë, institucionet e Kosovës tani më nuk kanë fuqi vendimmarrëse politike sepse rastet e tilla ndodhen në procedurë gjyqësore pranë Dhomës së Veçantë. E drejta e Kosovës mbrohet vetëm përmes përfaqësimit të drejtë pranë gjykatës, e drejtë kjo e cila është tejet e ngushtuar ose e mohuar për faktin se AKP përjashtohet nga përfaqësimi.
4. Në Kosovë mungon një bazë ligjore që disa ndërmarrje shoqërore me interes vital për Kosovën të transformohen dhe shndërrohen në ndërmarrje publike, kurse privatizimi i tyre të jetë përmes metodës së privatizimit të ndërmarrjeve publike ose partneritetit publiko-privat.
5. Baza e pa qartë ligjore dhe mos-shfuqizimi i ligjeve të Serbisë të nxjerra pas vitit 1989 lidhur me transformimin e pronës (privatizimin), ka krijuar hapësirë ligjore që këto ligje të shfrytëzohen për kthimin e pronave (prona bujqësore dhe banesave) të një numri të konsiderueshëm të ish-pronarëve, pronat e të cilëve janë nacionalizuar gjatë periudhës së komunizmit. Për trajtimin këtyre rasteve nuk ka bazë ligjore të nxjerrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Rekomandime:

1. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme duhet të ndryshohet dhe të shndërrohet në Ligj të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Dhoma e Veçantë formalo-juridikisht konsiderohet si pjesë e Gjykatës Supreme, edhe pse nuk i raporton asnjëherë. Me nxjerrjen e ligjit të ri duhet kushtëzuar kjo gjykatë që t'i raportojë për punën e saj Gjykatës Supreme të Kosovës, për krijimin e një praktike të njëjtë juridike në Kosovë.
2. Ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe harmonizimi i tij me Ligjin e ri për Dhomën e Veçantë. Gjithashtu me ndryshimin e këtij Ligji duhet të sqarohet se shfuqizohet çdo bazë ligjore për kthimin e pronave të nacionalizuara gjatë periudhës së komunizmit deri në nxjerrjen e një Ligji për denacionalizimin (kthimin ose kompensimin) e pronave të ish-pronarëve. Me ndryshimin e këtij ligji duhet të sqarohet edhe statusi i Fondit të Privatizimit dhe mundësia e investimit të këtyre mjeteve në ekonominë e Kosovës.
3. Ndryshimi i Rregullores nr. 2005/48 për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizim administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Me këtë ligj duhet të ngarkohet AKP dhe të evitohet mundësia që AKM të konsiderohet përgjegjëse për veprim lidhur me riorganizimin ose likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore. Gjithashtu, me këtë ligj duhet të parashihet, riorganizimi i disa ndërmarrjeve shoqërore me interes vital për Kosovën (në veçanti e Trepçës); së pari të transformohen në ndërmarrje publike kurse një pjesë e tyre mund të privatizohet me metodën e privatizimit të ndërmarrjeve publike, respektivisht me partneritet publiko-privat.
4. Nxjerrja e ligjit për denacionalizim (kthim ose kompensim) të pronave të ish-pronarëve. Me këtë ligj duhet të merret një qëndrim se si do të vepruhet me kërkesat pronësore të kësaj natyre që gjenden në procedurë pranë AKP-së dhe pranë Dhomës së Veçantë. Zgjidhja më e mirë për këto raste është kompensimi duke e shfrytëzuar Fondin e Privatizimit. Ndërsa, vlera e kompensimit duhet të jetë e arsyeshme duke i pasur parasysh mundësitë buxhetore të Kosovës.
5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të ushtrojë kontroll dhe të ndërmarrë masa në pajtim me ligjin, lidhur me vendimet e gjykatave vendore të cilat kanë zbatuar ligje të Serbisë të nxjerra pas viti 1990 lidhur me kthimin e pronave edhe pse bazë e vetme ligjore për privatizim ka qenë Ligji për AKM-në e më vonë Ligji për AKP-në.

Bibliografia

- Allen, Tom Restitution and transitional justice in European Court of Human Rights, *Columbia Journal of European Law*, Vol. 13, 2006-2007, pp. 1- 46
- Bennett, John, Estrin, Saul, Maw, James & Urga, Giovanni Privatization methods and economic growth, CEPR, Discussions Papers 4291, 2004
- Blacksell, Mark & Born, Karl Martin Private property restitution: the geographical consequences of official government policies in Central and Eastern Europe, *The Geographic Journal*, Vol. 168, No. 2, June, 2002, pp. 178-190
- Brus, Wlodzimierz Privatization in the transition process-recent experiences in Eastern Europe: General problems of privatization in the process of transformation of the post-communist economies, United Nation Publication, UNCTAD/GID/7, Geneva, November 1993, pp. 47-60
- Gelpern, Anna The laws and politics of reprivatization in East-Central Europe: A comparison, *U. Pa. J. Int'l Bus. L.*, Vol. 14. No. 3, 1993-1994, pp. 315-372
- Gordon, David Privatization in Eastern Europe: The Polish experience, *Law & Policy in International Business*, Vol. 25, 1993-1994, pp. 517-564
- Hanley, Eric & Treiman, Donald J. Did the transformation to post-communism in Eastern Europe restore pre-communist property relations? *European Sociological Review*, Vol. 20, No. 3, July 2004, pp. 237-252
- Havrylyshyn, Oleh Fifteen Years of Transformation in the Post-Communist World: Rapid Reformers Outperformed Gradualists, in: *Center For Global Liberty & Prosperity-Development Policy Analysis*, No. 4, 2007
- Heller, Michael & Serkin, Christopher Review: Revaluing Restitution: From Talmud to Post-Socialism, *Michigan Law Review*, Vol. 97, No. 6, 1999, pp. 1385-1412

- Jessel-Holst, Christa The revival of human rights and the reform of private law in post-communist Eastern European States, *Tel Aviv U. Stud. L.*, Vol. 12, 1994, pp. 127-144
- Karadjova, Mariana Property restitution in Eastern Europe: Domestic and International Human Rights Responses, *Review of Central and East European Law* 2004, No. 3, pp. 325-363
- Kornai, János Ten years after "The Road to a Free Economy": The author's self-evaluation, Paper for World Bank "Annual Bank Conference on Development Economics-ABCDE", Washington, D. C, April 18-20, 2000
- Kušić, Siniša Path-Dependency in the Process of Privatization, *The impact of privatization*, Frankfurt 2005
- Megginson, William L. & Netter, Jeffrey M. History and methods of privatization, in: David Parker & David Saal (eds.), *International Handbook on Privatization*, Cheltenham 2003, pp. 25-40
- Neff, Michael L. Eastern Europe's Policy of Restitution of Property in the 1990s, *Dickinson Journal of the International Law*, Winter 1992, pp. 357-381
- Pitelis, Christos & Clarke, Thomas The political economy of privatization, London 1993
- Preuß, Ulrich K. Restitution and privatization of property in the former GDR- The German case and some historical precedents, in: Frank Bönker & Ulrich K. Preuß (eds.), *Efficiency and Justice of Property Restitution in East Europe*, 1993, Bremen: Center for European Law and Policy (ZERP), pp. 47-72
- Ramamurti, Ravi A. Multilevel model of privatization in Emerging Economies, *The Academy of Management Review*, Vol. 25, No. 3, 2000, pp. 525-550
- Roland, Gérard & Verdier, Thierry Privatization in Eastern Europe, Irreversibility and critical mass effects, *Journal of Public Economics* 54 (1994), pp. 161-183
- Sinn, Hans-Werner Privatization in East Germany, Working Paper No. 3998, in: National Bureau of Economic Research - NBER, Cambridge, February 1992

Yilmaz, Akyuz

Privatization in the transition process-recent experiences in Eastern Europe: Reforms and Crisis in the transition Economies, United Nation Publication, UNCTAD/GID/7, Geneva, November 1993, pp. 3-24

Akte ligjore

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e hapur për nënshkrim me 4 Nëntor 1950, Europe. T.S. No. 5, 213 U.N.T.S. 221.
- Deklarata për Pavarësinë e Kosovës, 17 Shkurt 2008
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar me 9 Prillë 2008, e hyrë në fuqi me 15 Qershor 2008
- Ligji nr. 03/1 - 067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i miraturar me 21.05.2008
- Ligji i procedurës kontestimore, nr. 03/L-006
- Rregullorja e nr. 1999/1 për autorizimet e administratës së përkohshëm në Kosovë
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12 për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr.2005/18
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 për Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/48 për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:



Kjo analizë është përkrahur nga:

